



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



585
D
08.09.2026

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, duke u mbështetur në nenin 4 paragrafi 3.1, nenin 16, nenin 17 dhe nenin 18 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-088 dhe Ligjin Nr. 08/L-262, në nenet 5, 9, 10, 12, 13, 14 dhe 16 të Rregullores Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, si dhe në parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pas shqyrtimit të aplikacionit të KRU "Hidromorava" Sh.A., me nr. 459/D, datë 13.07.2026, për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit, më 08.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit

1. APROVOHET aplikacioni i KRU "Hidromorava" Sh.A., me nr. 459/D, datë 13.07.2026, për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit, sipas kushteve dhe obligimeve të përcaktuara me këtë vendim dhe Licencën e Shërbimit që i bashkëngjitet atij.
2. PËRTËRIHET/VAZHDOHET Licenca e Shërbimit e KRU "Hidromorava" Sh.A. dhe i lëshohet Licenca e Shërbimit me nr. L-09/2026-07, për periudhën pesë (5) vjeçare, nga data 11.09.2026 deri më 10.09.2031.
3. KRU "Hidromorava" Sh.A., me Licencën e Shërbimit nr. L-09/2026-07, autorizohet për ofrimin e shërbimeve sipas kategorive në vijim:
 - 3.1. Kategoria A – Shërbimet e Ujësjiellit;
 - 3.2. Kategoria B – Shërbimet e Kanalizimit;
4. Zona e shërbimit për të cilën lëshohet Licenca e Shërbimit përfshin komunat e përcaktuara me aktin nënligjor në fuqi të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe, për qëllim të këtij vendimi, komunat si në vijim:
 - 4.1. Gjilan;
 - 4.2. Kamenicë;
 - 4.3. Viti;
 - 4.4. Partesh;
 - 4.5. Novobërdë dhe
 - 4.6. Ranillug.
5. KRU "Hidromorava" Sh.A. obligohet që shërbimet për të cilat licencohet t'i ofrojë në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, legjislacionin ndryshues dhe plotësues të tij, Rregulloren Nr. 16/2025, aktet e nxjerra nga ARRU, kushtet e Licencës së Shërbimit dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

6. KRU "Hidromorava" Sh.A., gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Licencës së Shërbimit, obligohet të ruajë dhe përmbushë kushtet dhe kriteret mbi bazën e të cilave është bërë përtëritja/vazhdimi i licencës dhe t'i nënshtrohet monitorimit dhe inspektimit të ARRU-së.

7. KRU "Hidromorava" Sh.A. obligohet që, lidhur me Komunën e Ranillugut, të ndërmarrë pa vonesë të gjitha veprimet që varen prej saj për lidhjen e Marrëveshjes për Shërbime, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe ta informojë ARRU-në për çdo zhvillim të mëtejshëm deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

7.1. ARRU do të bëjë monitorim dhe verifikim të përmbushjes së këtij obligimi lidhur me nënshkrimin e Marrëveshjes për Shërbime me Komunën e Ranillugut, jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dhe sipas nevojës të ndërmerren masat përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. KRU "Hidromorava" Sh.A. obligohet të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga Memorandumi i Mirëkuptimit, i bashkëngjitur këtij vendimi, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në të, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e tyre brenda afateve të parapara.

9. Licenca e Shërbimit me nr. L-09/2026-07 i bashkëngjitet këtij vendimi dhe përbën pjesë përbërëse të tij.

ARSYETIM

KRU "Hidromorava" Sh.A., me seli në Gjilan, si ofrues ekzistues i licencuar i shërbimeve të ujit, ka paraqitur pranë Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) aplikacionin me nr. 459/D, datë 13.07.2026, për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit, së bashku me dokumentacionin dhe dëshmitë përkatëse për zhvillimin e procedurës së licencimit.

Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-088 dhe Ligjin Nr. 08/L-262, përcakton kompetencat e ARRU-së, procedurën e licencimit dhe kushtet që duhet t'i përmbushë ofruesi i shërbimeve. Rregullorja Nr. 16/2025 përcakton në mënyrë të hollësishme kriteret, dokumentacionin, procedurën e përtëritjes/vazhdimin të licencës, përmbajtjen e licencës, obligimet e të licencuarit, monitorimin dhe masat rregullatore.

Në veçanti, neni 17 paragrafi 2.3 i Ligjit Nr. 05/L-042, i riformuluar me nenin 3 të Ligjit Nr. 06/L-088, përcakton se ofruesi pranon përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve përmes marrëveshjes për shërbime me komunat në tërë zonën e shërbimit, të përcaktuar me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në të njëjtën frymë, neni 9 paragrafi 1.5 i Rregullores Nr. 16/2025 kërkon që aplikuesi të pranojë përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve të ujit përmes marrëveshjes me komunat në zonën e shërbimit.

Aplikacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nga KRU "Hidromorava" Sh.A. i janë nënshtruar shqyrtimit dhe vlerësimit nga Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për përtëritjen/vazhdimin e licencave të shërbimit. Komisioni ka vlerësuar kapacitetet profesionale, teknike, operative, financiare dhe administrative të ofruesit, respektimin e kushteve të licencës ekzistuese dhe dokumentacionin tjetër të kërkuar me Rregulloren Nr. 16/2025.

Nga shqyrtimi është konstatuar se kushtet dhe kriteret e tjera materiale për përtëritjen/vazhdimin e licencës janë përmbushur, ndërsa në raport me Komunën e Ranillugut ka mbetur e pazgjidhur çështja e nënshkrimit të Marrëveshjes për Shërbime. ARRU nuk e ka trajtuar këtë mungesë si të parëndësishme dhe as si të

përmbushur; përkundrazi, e ka evidentuar shprehimisht si çështje juridike relevante që duhet të vazhdojë të përmbushet dhe të mbikëqyret.

Gjatë procedurës, duke pasur parasysh se shërbimet e ujit janë jetike për njerëzit, ARRU ka ndërmarrë veprime konkrete për sqarimin dhe tejkalimin e kësaj çështjeje. Më 04.09.2026, Zëvendësudrejtori i ARRU-së ka zhvilluar takim me Drejtorin e Shërbimeve Publike të Komunës së Ranillugut dhe Kryeshefin Ekzekutiv të KRU "Hidromorava" Sh.A., me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje dhe arritjes së marrëveshjes ndërmjet palëve. Megjithatë, edhe përkundër përpjekjeve të ndërmarra, deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi Marrëveshja për Shërbime nuk është nënshkruar. Komuna e Ranillugut ka arsyetuar qëndrimin e saj me mungesën e investimeve në infrastrukturën e rrjetit të ujësjellësit dhe me furnizimin jo të rregullt me ujë, ndërsa njëkohësisht ka shprehur qëndrimin se nuk synon të paraqesë pengesë për licencimin e nevojshëm për vazhdimin e veprimtarisë së KRU "Hidromorava" Sh.A. Çështja është ngritur për trajtim edhe pranë institucioneve kompetente të nivelit qendror, me qëllim të koordinimit institucional dhe gjetjes së një zgjidhjeje të qëndrueshme.

Në vlerësimin juridik të kësaj rrethane, ARRU ka marrë parasysh se KRU "Hidromorava" Sh.A. është ofrues ekzistues i vetëm i shërbimeve në zonën përkatëse dhe se mos nënshkrimi i Marrëveshjes, sipas provave të administruara deri në momentin e vendimmarrjes, nuk është rezultat i refuzimit të ofruesit për të pranuar përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve, por i një mosmarrëveshjeje institucionale për zgjidhjen e së cilës ofruesi nuk disponon kompetencë të njëanshme. Megjithatë, kjo rrethanë nuk e përjashton dhe nuk e shuan detyrimin ligjor për lidhjen e Marrëveshjes.

ARRU ka pasur parasysh gjithashtu natyrën esenciale dhe të vazhdueshme të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe detyrimin e vet rregullator për të siguruar që ofruesit të operojnë nën një kuadër të vlefshëm licence, standardesh dhe mbikëqyrjeje. Mungesa e një vendimi rregullator për një ofrues ekzistues të shërbimeve, pa ekzistuar një zgjidhje tjetër institucionale për zonën e shërbimit, do të mund të krijonte pasiguri juridike dhe rrezik për vazhdimësinë, kontrollin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve publike esenciale.

Në këtë kontekst, ARRU ka zbatuar parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Masa e zgjedhur nuk e anulon kërkesën e nenit 17 paragrafi 2.3 të Ligjit dhe nenit 9 paragrafi 1.5 të Rregullores, por synon të ruajë vazhdimësinë e regjimit rregullator, duke e shoqëruar licencën me një kusht të posaçëm, të matshëm dhe të mbikëqyrur për zgjidhjen e çështjes së Marrëveshjes me Komunën e Ranillugut.

Kjo qasje mbështetet edhe në kompetencat e ARRU-së për përcaktimin e kushteve të licencës, për monitorimin dhe inspektimin e përmbushjes së tyre dhe për ndryshimin, plotësimin, pezullimin apo revokimin e licencës kur krijohen kushtet ligjore. Neni 10 i Rregullores Nr. 16/2025 kërkon që licenca të përbajë, ndër të tjera, zonën e shërbimit dhe përshkrimin e kushteve të licencës; neni 14 përcakton obligimet e vazhdueshme të të licencuarit; neni 16 i jep Autoritetit kompetencë monitorimi dhe inspektimi; ndërsa nenet 17 dhe 18 përcaktojnë masat e revokimit dhe pezullimit në rastet e parashikuara me Rregullore.

Për këtë arsye, në pikën 7 të dispozitivit është vendosur kusht i posaçëm që KRU "Hidromorava" Sh.A. të ndërmarrë të gjitha veprimet, që varen prej saj, për lidhjen e Marrëveshjes për Shërbime me Komunën e Ranillugut, të raportojë në ARRU dhe t'i nënshtrohet rivlerësimit formal jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga hyrja në fuqi e vendimit. Kjo periudhë nuk përbën shtyrje apo heqje dorë nga detyrimi ligjor, dhe

ARRU mund të veprojë edhe para përfundimit të saj nëse konstatohet mosveprim i ofruesit apo ndryshim i rethanave relevante.

ARRU, ka vlerësuar edhe interesin publik për qasje të vazhdueshme në ujë të sigurt dhe shërbime sanitare. Në këtë drejtim, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtën e fëmijës për qasje në ujë të pijshëm të pastër sipas nenit 24 paragrafi 2 pika (c) të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, e zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës sipas nenit 22 të Kushtetutës, përforcojnë rëndësinë e shmangies së masave që do të rrezikojnë pa nevojë vazhdimësinë e një shërbimi esencial. Ky standard ndërkombëtar përdoret si mbështetje interpretuese e interesit publik dhe jo si bazë për përjashtim nga kushtet ligjore të licencimit.

Pas përfundimit të shqyrtimit, Komisioni ka rekomanduar përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit të KRU "Hidromorava" Sh.A., duke evidentuar në mënyrë të veçantë çështjen e Marrëveshjes për Shërbime me Komunën e Ranillugut dhe nevojën për trajtim, koordinim institucional, monitorim dhe rivlerësim të vazhdueshëm.

ARRU, duke marrë për bazë aplikacionin, dokumentacionin dhe provat e administruara, rezultatet e shqyrtimit, rekomandimin e Komisionit, obligimet që rrjedhin nga legjislacioni i sektorit dhe nevojën për ruajtjen e një kuadri të vazhdueshëm rregullator për shërbimet esenciale, ka vendosur për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit të KRU "Hidromorava" Sh.A., me kushtin e posaçëm dhe mekanizmat e mbikëqyrjes të përcaktuar në dispozitiv.

Për arsyet e cekura më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet mjeti juridik në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe legjislacionin e posaçëm në fuqi për rregullimin e shërbimeve të ujit, brenda afatit ligjor nga dita e pranimit të vendimit.

Vendimi u dorëzohet:

- Arkivit të ARRU-së;
- KRU "Hidromorava" Sh.A.;
- Te gjitha Departamenteve të ARRU;
- Njësisë për Inspektim.

